



REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË
Nr. 176 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
Nr. 3104 Prot.

AKT - MARRËVESHJE

Në Tiranë, sot, më datë 1.07.2004, lidhet kjo akt marrëveshje, ndërmjet:

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, i cili më poshtë do të quhet **ILDKP**, i përfaqësuar nga Inspektor i Përgjithshëm, znj. Fatmira Laska;

dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, i cili më poshtë do të quhet **DPSHTRR**, i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z. Shpëtim Cami.

Të dy subjektet nënshkruese të kësaj akt marrëveshje, me qëllim:

realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare;

rritjen e efikasitetit dhe bashkrendimin e punës ndërmjet institucioneve për kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe detyrimeve financiare;

koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta institucionale në kuadrin e parandalimit të korrupsionit dhe të luftës kundër tij;

bien dakort si më poshtë:

1. Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje në frymën e nenit 26 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".
2. DPSHTRR anagazhohet që të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive çdo informacion apo të dhënë që

disponon ky institucion dhe ato të vartësisë, që lidhen me kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe detyrimeve financiare.

3. DPSHTRR do të caktojë një strukturë të posacme si pikë kontakti me ILDKP, në mënyrë që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

4. Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave do të bëhet në cdo rast me shkresë të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKP-së.

5. DPSHTRR është e detyruar që, jo më vonë dhe 15 ditë nga marrja e kërkesës për të dhënat që gjenden në arkivën qendrore dhe në arkivat e drejtorive vartëse, të vërë në dispozicion të personit të autorizuar nga ILDKP, të dhënat e kërkuara. Në cdo rast të dhënat do të jenë shkresore. Ato duhet t'i përgjigjen drejtpërdrejt kërkesës së bërë dhe nuk duhet të jenë të përgjithshme.

6. Kjo marrëveshje nëshkruhet sot më datë 1.07.2004 dhe fillon zbatimin e saj menjëherë.

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË**

Inspektori i Përgjithshëm

FATMIRA LASKA



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE
TË TRANSPORTIT RRUGOR**

Drejtori i Përgjithshëm

SHPËTIM CAMI

